


ÇFARË ROLI LUAN QEVERIA NË PËRSHPEJTIMIN E TRANZICIONIT ENERGJETIK?

08/2024



Pjesëmarrja e qeverisë është shumë-dimensionale dhe thelbësore për drejtimin e tranzicionit energjetik. Përmes politikave strategjike, stimujve financiarë, zhvillimit të infrastrukturës, edukimit publik dhe bashkëpunimit ndërkombëtar, qeveria mund të krijojë një mjedis mbështetës që përshpejton kalimin drejt një të ardhme të qëndrueshme dhe me më pak karbon.

Disa fusha kryesore ku veprimet e qeverisë janë të domosdoshme:

Politika dhe rregullore

Qeveria vendos kuadrin ligjor dhe rregullativ për të mundësuar tranzicionin në sektorin e energjetisë. Duke miratuar politika që promovojnë energjinë nga burimet e ripërtritshme, eficiencën e energjisë dhe dekarbonizimin. Veprimet kryesore të qeverisë përfshijnë:

- Vendosja e objektivave për burimet e ripërtritshme;
- Zbatimi i çmimeve të karbonit: Futja e taksave ose sistemeve të tregtimit të karbonit për të reduktuar emetimet e gazeve serrë;
- Zbatimi i standardeve për eficiencën e energjisë;

Stimujt financiarë

Qeveritë ofrojnë mbështetje financiare për të inkurajuar adoptimin e teknologjive të pastra energjetike dhe zhvillimin e infrastrukturës. Kjo përfshin:

- Subvencione dhe grante si ndihmë financiare për projektet e BRE-ve dhe teknologjitë e eficiences së energjisë;
- I lehtësira tatimore që shërbejnë si kredi për individët dhe kompanitë që investojnë në energji të rinovueshme ose përmirësime të efikasitetit energjetik;
- Kredi me interes të ulët dhe garanci për të lehtësuar çasje në kapital financiar për projektet e energjisë së pastër përmes opsioneve të favorshme të financimit;



Zhvillimi i Infrastrukturës

Investimet e qeverisë në infrastrukturë janë të domosdoshme për të mbështetur tranzicionin energjetik. Kjo përfshin:

- Modernizimi i Rrjetit Elektrik për të përballuar variabilitetin e burimeve të energjisë së ripërtritshme dhe për të siguruar furnizim të besueshëm;
- Investimi në sisteme të eficiencës sa i përket transportit publik për të reduktuar varësinë nga automjetet e fuqizuara me lëndë djegëse fosile.

Ndërgjegjësimi dhe Edukimi Publik

Edukimi i publikut dhe promovimi i ndërgjegjësimit për përfitimet e tranzicionit energjetik është thelbësor për të fituar mbështetje të gjerë. Qeveritë mund të:

- Organizojnë fushata ndërgjegjësimi për të informuar qytetarët për praktikatat e kursimit të energjisë dhe rëndësinë e energjisë së rinovueshme;
- Integrojnë tema të tranzicionit energjetik në kurrikulat shkollore dhe të ofrojnë programe trajnimi për profesionistët në sektorin e energjisë;

CILAT
POLITIKA
DUHET
NDJEKUR?




Për të ndjekur një tranzicion të suksesshëm të energjisë, Kosova duhet të ndërmarrë një sërë politikash që mbështesin kalimin nga burimet tradicionale të energjisë fosile në burimet e energjisë së rinovueshme dhe efikasitetin energjetik. Këto politika mund të përfshijnë:

Sigurimi i mekanizmave mbështetës financiar dhe rregullator për të tërhequr investime në infrastrukturën e energjisë së ripërtitshme.



Vendosja e objektivave të qarta dhe ambicioze për pjesën e energjisë së rinovueshme në përzierjen e prodhimit të energjisë elektrike përtej vitit 2031, që nënkupton zhvillimin dhe aprovimin e strategjisë afatgjate drejt dekarbonizimit të plotë të sektorit të energjisë deri në vitin 2050.

Zhvillimi i kornizave për tërheqjen e investimeve të sektorit privat në projektet e prodhimit të energjisë elektrike përmes mekanizmave të tillë si partneriteti publik-privat dhe tarifave nxitëse.



Krijimi i një sistemi të fuqishëm monitorimi dhe vlerësimi për të siguruar suksesin e objektivave strategjike.

Krijimi i një fondi të dedikuar për financimin e projekteve të energjisë elektrike të pastër, duke ofruar mbështetje financiare, kredi ose garanci.



Zhvillimi i një udhërrëfyese për largimin gradual nga lëndët djegëse fosile dhe rritjen e përdorimit të burimeve të pastra dhe të qëndrueshme të energjisë.

Hulumtimi i mundësive të bashkëpunimit me vendet fqinje për projekte ndërkufitare të energjisë elektrike, si burimet e përbashkëta të energjisë së ripërtitshme. Si mundësi është Shqipëria; bashkëpunim me favor të dyanshëm.



Strategji për zhvillimin dhe zbatimin e politikave nacionale për modernizimin e infrastrukturës së rrjetit të energjisë elektrike, përfshirë integrimin e burimeve të rinovueshme dhe teknologjive të rrjetit inteligjent.

Organizimi i fushatave për të edukuar qytetarët për përfitimet e kalimit në energji elektrike të pastër dhe inkurajimi i praktikave të efijencës së energjisë.



Inkurajimi i prodhimit të decentralizuar të energjisë për të rritur elasticitetin e rrjetit dhe për të fuqizuar komunitetet lokale.

Nxjtja e angazhimit të komunitetit në përpjekjet për ruajtjen e energjisë elektrike dhe organizimi i nismave për kursimin e energjisë.



Thjeshtësimi i proceseve rregullatore dhe krijimi i një mjedisi të favorshëm për projektet e energjisë së ripërtitshme.

Ofrimi i programeve të trajnimit dhe seminareve për të rritur ndërgjegjësimin dhe aftësitë në lidhje me praktikën e qëndrueshme të energjisë.



Një rishikim i plotë i faktorëve që shkaktojnë vonesa në ankande dhe respektimi i afateve kohore të zbatimit.

Kush dhe çfarë duhet të bëj?

QEVERIA E KOSOVËS

Qeveria e Kosovës, përmes Ministrisë së Ekonomisë, ka përgjegjësinë kryesore për të vendosur objektiva të qarta dhe ambicioze për energjinë e ripërtrishme dhe dekarbonizimin. Për të arritur këtë, duhet të hartohet një udhërrëfyes për largimin gradual nga lëndët djegëse fosile dhe rritjen e përdorimit të burimeve të pastra të energjisë. Në bashkëpunim me MMPHI duhet të thjeshtohen procedurat e lejeve dhe të krijohet një mjedis rregullator të favorshëm për projektet e energjisë së ripërtrishme, si dhe të integrojnë kërkesat mjedisore në proceset rregullatore.

ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI (ZRRE)

ZRRE duhet të përmirësojë rregulloret për të mbështetur integrimin e burimeve të rinovueshme në rrjetin elektrik dhe të krijojë një treg për certifikatat e energjisë së ripërtrishme për të mbështetur prodhimin dhe konsumimin e energjisë së pastër.

ZYRA E RRRKOMUNITETET LOKALE

DHE BIZNESET: NXITJA E PRODHIMIT TË DECENTRALIZUAR

Komunat dhe organizatat lokale duhet të nxisin iniciativat për instalimin e paneleve diellore dhe turbinave me erë në shkallë të vogël. Bizneset dhe konsumatorët duhet të marrin pjesë aktive në programet për prodhimin dhe përdorimin e energjisë së rinovueshme, duke rritur elasticitetin e rrjetit dhe fuqizuar komunitetet lokale.

FONDI I KOSOVËS PËR EFIÇIENCË TË ENERGJISË

Duke u mbështetur në praktikat ndërkombëtare ky fond duhet të krijojë fonde të dedikuara për financimin jo vetëm për projektet e efijences se energjisë, por edhe për projektet e energjisë elektrike nga BRE-te, duke ofruar mbështetje financiare dhe stimuj për përmirësimin e efijences se energjisë dhe instalimin e BRE-ve në sektorin rezidencial dhe komercial.



OPERATORI I SISTEMIT, TRANSMISIONIT DHE TREGUT (KOSTT)

KOSTT duhet të zhvillojë dhe zbatojë strategji për përmirësimin dhe zgjerimin e rrjetit të energjisë elektrike për të akomoduar burimet e ripërtrishme. Të ofroj zgjidhje për ruajtjen e energjisë elektrike që sherben për optimizim të prodhimit të energjisë elektrike nga BRE-te që do të ndikojë në balancim të sistemit elektroenergjetik dhe siguri të furnizimit.

INSTITUCIONET FINANCIARE DHE INVESTITORËT PRIVATË

Bankat dhe institucionet financiare duhet të ofrojnë kredi dhe garanci të favorshme për projektet e energjisë së rinovueshme. Investitorët privatë mund të investojnë në projekte të energjisë së pastër përmes partneriteteve publik-privat dhe tarifave nxitëse, duke bërë këto projekte ekonomikisht të qëndrueshme.

INSTITUCIONET ARSIMORE DHE ORGANIZATAT E SHOQËRISË CIVILE

Universitetet dhe shkollat duhet të ofrojnë programe trajnimi dhe edukimi për teknologjitë e energjisë së rinovueshme. Organizatat joqeveritare mund të organizojnë fushata ndërgjegjësuese për përfitimet e energjisë së pastër dhe praktikat e qëndrueshme.

BASHKËPUNIMI RAJONAL

Qeveria dhe KOSTT duhet të hulumtojnë mundësitë për projekte ndërkufitare të energjisë elektrike me vendet fqinje, si Shqipëria. Kjo mund të përfshijë burime të përbashkëta të energjisë dhe iniciativat për rritjen e sigurisë së furnizimit me energji në mes dy vendeve.

MONITORIMI DHE VLERËSIMI

Qeveria dhe ZRRE duhet të zhvillojnë një sistem të fuqishëm monitorimi dhe vlerësimi për të siguruar suksesin e objektivave strategjike dhe për të identifikuar pengesat dhe zgjidhjet e tyre.

NJË QASJE GJITHËPËRFSHIRËSE DHE BASHKËPUNUESE, QË PËRFSHIN TË GJITHË AKTORËT KYÇ, ËSHTË JETIKE PËR TË REALIZUAR TRANZICIONIN E ENER GjISË NË KOSOVË DHE PËR TË ARRITUR OBJEKTIVAT PËR NJË TË ARDHME ENER GjIE TË QËNDRUESHME DHE DEKARBONIZIM TË PLOTË. KJO QASJE DUHET TË PËRFSHIJË VEPRIME KONKRETE DHE TË MIRËKOORDINUARA NË TË GJITHA NIVELET, NGA QEVERIA QENDRORE DERI TE KOMUNITETET LOKALE DHE INVESTITORËT PRIVAT.



Cilat janë treguesit kryesor të tranzicionit të energjisë elektrike në KOSOVË?

Një përgjigje më e qartë përcjellur me shembuj konkretë do të shpaloset në botimin vijues!

Përmbajtja e këtij punimi është përgjegjësi vetëm e Institutit për Politika Zhvillimore (INDEP) dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Heinrich Böll Stiftung (HBS).